



AKT THEMELIMI I SHOQERISE "Auditing Partners" sh.p.k

I hartuar prej paleve :

1. Kristaq Kalam Ndini me 75% te kapitalit
2. Enriketa Agron Ndini me 15% te kapitalit
3. Ervin Koco Themeli me 10% te kapitalit.

Te tria palet duke qene te pranishem, te deklaruar ortake rane dakord qe Aktin e themelimit te shoqerise se perbashket ta formulojne sipas kerkesave te ligjit Nr.7638 date 19.02.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe vendosen sa me poshte:

ENI 1

Te krijojne shoqerine tregetare me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k) e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kesaj kontrate, me statutin e perbashket dhe ligjin 7638 dt. 19.02.1992 " Per shoqerite tregetare".
Kjo shoqeri do te emertohet " Auditing Partners" sh.p.k.

ENI 2

Shoqeria "Auditing Partners" sh.p.k me qender ne Tirane, Rr."Perlat Rexhepi" Nr 16, ap. 12 do te ushtroje veprimtari per nje periudhe kohe mbi 10 vjet.

ENI 3

Shoqeria "Auditing Partners" sh.p.k do te kete per objekt te veprimtarise se saj: Auditim I llogarive, konsulence financiare, kontroll I llogarive per likujdim shoqerish, bashkim shoqerish e veprime te ndryshimeve te kapitalit themeltar etj,. Per cdo sherbim ekonomiko-financiar qe rregullojne kete profesion.

ENI 4

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, vendqendrimin dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marrin me miratim te perbashket tre ortaket.

ENI 5

Per realizimin e objektivave te shoqerise ortaket rane dakord te bashkojne kapitalet e tyre, per persosjen e organizimit e zhvillimin e veprimtarise se saj. Kapitali themeltar I shoqerise do te jete 100.000 leke te reja dhe perbehet nga kontributet e tre ortakeve te ndare ne:

- | | |
|-------------------------|-----|
| 1. Kristaq Kalam Ndini | 75% |
| 2. Enriketa Agron Ndini | 15% |
| 3. Ervin Koco Themeli | 10% |

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkuar e shlyer krejtesisht, pastaj jane ndare ndermjet ortakeve si me siper.

Cdo kuote I takon e drejta e nje vote.

K. Ndini

E. Ndini

E. Themeli

NENI 6

Kapitali I shoqerise mund te shtohet ose pakesohet sipas vendimeve qe do te marrin ortakët, por ne asnje rat nje ortak nuk mund te detyroje ortakun tjetër te rrise kuoten e tij ne kapitalin e shoqerise.

Ne rast se kapitali I shoqerise per shkak te humbjeve te vertetuara ne dokumentet financiare, rezulton me I vogel se gjysma e kapitalit themeltar ortakët vendosin brenda tre muajve nga miratimi I llogarive te percaktojne kete humbje mbi mundesine e prishjes se parakohshme te shoqerise. Ne rast se prishja nuk shpallet, shoqeria zvogelon kapitalin e saj me nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

NENI 7

Ortaku qe deshiron t'u shese te tretteve kuota te kapitalit te tij, teresisht apo pjeserisht, duhet te njoftoje ortakët e tjere te shoqerise, te cilet kane te drejten e parablerjes qofte dhe ne kushte te barabarta. Kjo e drejte duhet ushtruar brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

NENI 8

Organet drejtuese te shoqerise jane:

Asambleja

Administratori

Procedura per emerimin ne funksionet perkatese dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit te shoqerise.

NENI 9

Asambleja drejtohet nga administratori I shoqerise. Ortakët themelues te shoqerise kane zgjedhur si administrator te saj Z. Kristaq Kalam Ndini.

NENI 10

Vendimet e Asamblese jane te vlefshme nese jane miratuar nga te tre ortakët e saj. Vendimet e Asamblese mund te merren edhe nepermjet konsultimit me shkrim, nese nje nga ortakët nuk ka kerkuar mbledhjen e Asamblese.

NENI 11

Likuiditetet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ato te huaja ku shoqeria ka llogarite e saj rjedhese.

Per kapitalin themeltar te shoqerise eshte hapur libri I llogarive ku do te shenohet kontributi I secilit ortak. Po keshtu shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin sipas kerkesave te ligjit per kontabilitetin e gjithë kerkesave te tjera financiare, te domosdoshme per veprimtarine normale te saj.

NENI 12

Fitimi neto I realizuar nga shoqeria do te ndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me kontributin e secilit ne kapitalin themeltar te shoqerise, pasi te jene likuiduar te gjitha detyrimet, dhe te jete hequr 5% qe do te futet ne fondin e rezerves ligjore deri ne permbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqerise.

Z. Ndini

E Ndini

E. J. Ndini

NENI 13

Shoqeria e fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 14

Ortaket jane te detyruar te ruajne karakterin sekret te dokumentacionit, te eksperiences se shkembyer te realizuar brenda veprimtarise se shoqerise.

NENI 15

Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim do te paraqiten per zgjidhje ne gjykatën kompetente shqiptare ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 16

Ne rast zgjidhje te kontrates, Asambleja percakton menyren e likujdimit dhe emerone nje ose me shume likuidatore sipas normave ligjore.

NENI 17

Ky Akt Themelimi u perpilua ne prani te tre ortakeve duke shprehur ne te vullnetin e lire te tyre.

Akti I themelimit u perpilua ne tre kopje me fuqi te barabarta secila per t'u depozituar ne organet gjyqesore dhe tatimore si dhe nje kopje te ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE "Auditing Partners" sh.p.k.

Kristaq Ndini

Kristaq Ndini

Enriketa Ndini

Enriketa Ndini

Ervin Themeli

Ervin Themeli



STATUTI

I SHOQERISE “ Auditing Partners” sh.p.k

1. Krijimi I shoqerise.

Shoqeria “Auditing Partners” sh.p.k eshte krijuar sipas Aktit te themelimit qe I bashkalidhet ky statut I perpiluar dhe I nenshkruar nga :

- 1.Kristaq Kalam Ndini
- 2.Enriketa Agron Ndini
3. Ervin Koco Themeli

Me cilesine e ortakeve te shoqerise.

Shoqeria eshte krijuar dhe e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me normat e ketij statuti si dhe te legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.Kjo shoqeri eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

2. Objekti i shoqerise.

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: Auditim I llogarive, konsulence financiare, kontroll I llogarive per likujdim shoqerish, bashkim shoqerish e veprime te ndryshimeve te kapitalit themeltar etj,. Per cdo sherbim ekonomiko-Financiar qe rregullojne kete profesion.

3. Emri, selia, territori.

Kjo shoqeri quhet “Auditing Partners” sh.p.k dhe e fiton personalitetin juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregetar ne Gjykatën e rrethit Tirane.

Shoqeria e ka qendren e saj ne qytetin e Tiranes ku zhvillohet aktiviteti i saj kryesor ekonomik.

Selia e saj eshte ne Rruga “Perlat Rexhepi”, Nr 16, ap.12, Tirane.

Shoqeria do ta zhvilloje veprimtarine e saj ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise.

Ajo mund te krijojë dege ose perfaqesi ne rrethe te ndryshme te Shqiperise.

4. Kapitali themeltar i shoqerise.

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributi I te tre ortakeve ne shumen prej 100.000 leke.

Kapitali themeltar depozitohet ne nje banke te qytetit te Tiranes, ose ne nje zyre noterie.

Kapitali themeltar mund te shtohet ne varesi te rezultateve dhe ne perputhje me normat e legjislacionit ne fuqi.

Kristaq Kalam

Enriketa Agron

Ervin Koco

Kapitali themeltar mund te shtohet edhe nepermjet pranimit te ortakeve te tjere.

Kapitali themeltar mund te transferohet jashte shoqerise ose te lihet peng ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem ne rruge trashegimie. Bashkeshortet, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit, me vendim te tre ortakeve dhe sipas kushteve te parashikuara ne ligj.

Shoqeria mund te kete edhe kontribute ne natyre ku perfshihen te gjitha sendet e palujtshme si dhe makinerite e pajisjet e ndryshme qe vijne ose kalojne ne pronesi te shoqerise.

5. Fondet e shoqerise.

Shoqeria percakton fondet e meposhtme:

- a- Fondin themeltar (qarkullues).
- b- Fondin rezerve.
- c- Fonde te tjera te cilat mund te jene te nevojshme gjate veprimtarise se saj.

Masa e secilit fond dhe menyra e perdorimit te tij percaktohet me vendim te organit drejtues te shoqerise.

6. Organi drejtues dhe administrimi i shoqerise.

Organet drejtuese te shoqerise do te jene:

Asambleja
Administratori

E gjithe veprimtaria e shoqerise percaktohet nga administratori i saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Per administrimin e shoqerise ose te veprimtarive te vecanta te saj, administratori kryesor, mund te emeruje nje ose disa administratore te tjere.

Kompetencat e administratoreve te tjere te mundshem percaktohen ne aktin e emerimit te tyre.

Shoqeria nuk merr persiper veprimet e ndryshme qe mund te kryejne administratoret e tjere te mundshem ne marrdhenie me te tretet, te cilat i tejkalojne kompetencat e tyre te percaktuara ne aktin e emerimit.

Administratori per te shqyrtuar bilancin vjetor, te ardhurat e qarkulluara si dhe menyren e mbajtjes se regjistrave te veprimeve kontabel, emerone nje ose disa

F. Ndini

F. Ndini

E. Ruzhica

eksperte kontabel. Emerimi i eksperteve kontabel eshte i detyrueshem per rastet e parashikuara ne ligj.

7. Kompetencat e administratorit.

Vendos per politikat afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.

Emeron dhe shkarkon administratoret e tjere te mundshem dhe percakton kompetencat e tyre ne aktin e emerimit.

Shqyrton bilancin vjetor, kuotat e fondeve te ndryshme dhe fitimin e realizuar.

Vendos per krijimin e degeve ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive te perbashketa.

Vendos per marrjen e kredive si dhe per mbarimin e shoqerise, nese ne dokumentet financiare, rezultatet e shoqerise vleresohen me humbje.

Vendos per shnderrimin e shoqerise nga Sh.p.k. ne shoqeri te llojeve te tjera.

Realizon ose miraton cmimet e shitjes dhe te sherbimeve.

Vendos per pagat e personelit te shoqerise.

Ndjek problemet e shoqerise ne marrdhenie me organet e ndryshme shteterore dhe me persona te tjere fizike dhe juridike.

8. Menyra e perfaqesimit.

Shoqeria perfaqesohet nga administratori i saj, ne te gjitha marrdheniet juridike civile me persona te tjere fizike e juridike si dhe me organet e ndryshme shteterore.

Ajo mund te perfaqesohet edhe nga ndonje person tjeter i autorizuar prej administratorit te saj me prokure te posacme ose me autorizim te vecante.

9. Fitimi.

Pas perballimit te detyrimeve , taksave, tatimeve, shpenzimeve te ndryshme per pagat e punonjesve etj., fitimi ndahet ndermjet tre ortakeve ne masen e kontributit te tyre per secilin ortak.

Fitimi neto mund te transferohet jashte Republikes se Shqiperise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

F. Adini

E. Adini

E. Duvushi

Fitimi mund te perdoret per zgjerimin e kapitalit themeltar, per zgjerimin e tij me kontribute ne natyre, per shtimin e fondeve te shoqerise si dhe per qellime te tjera qe nuk vijne ne kundërshtim me ligjin.

10. Kohezgjatja e shoqerise.

Shoqeria krijohet per nje periudhe mbi 10 vjet.

11. Marrdheniet e punesimit.

Cdo person duke perfshire edhe administratoret e tjere te mundshem, do te punesohen ne shoqeri mbi bazen e kontrates se punes te lidhur ndermjet tij dhe administratorit te shoqerise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

12. Pergjegjesia e punonjesve.

Cdo person i punesuar ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e detyres. Ai eshte i detyruar te permbushe detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e punes, nga vendimet e administratorit, si dhe nga statuti i shoqerise. Per shkelje te natyres se mesiperme, si dhe per shkelje te legjislacionit ne fuqi, prej te cilave shoqerise mund t'i shkaktohen deme, ndaj secilit prej tyre mund te merren masa te ndryshme deri ne largimin nga puna, ne perputhje dhe me legjislacionin e punes ne fuqi.

13. Konfidencialiteti.

Te gjithe personat qe do te punesohen ne shoqeri jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionit, te njohurive dhe pervojes se shkëmbyer si dhe te cdo lloj materiali tjetër konfidencial dhe duhet te adaptojne te gjitha masat e nevojshme per te parandaluar perhapjen e tyre qofte edhe pjeserisht.

Masat e parashikuara ne nenin 12 mund te merren ndaj atyre qe kryejne mosrespektimin e konfidencialitetit te parashikuar ne paragrafin e mesiperme.

14. Mbarimi i shoqerise.

Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te organit drejtues, pra Asamblese se ortakeve ne rast se veprimtaria e saj nuk rezulton fitimprurese, si dhe per shkaqe te tjera te parashikuara ne ligj.

Shoqeria mund te mbaroje edhe me ane te riorganizimit nepermjet formave te thithjes dhe te bashkimit.

F. Adini

E. Ndini

Q. J. J. J.

Gjate fazes se likujdimit, pergjegjesia e administratorit dhe likujdatorit eshte e njejte.

15. Dispozita te fundit.

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne nje nga shoqerite e sigurimit qe operojne ne vendin tone.

Shoqeria ka vulen e saj, forma dhe madhesia e se ciles percaktohen nga administratori kryesor.

Statuti i shoqerise u miratua nga tre ortaket e shoqerise "Auditing Partners sh.p.k sot me dt 02.05.2006.

Kristaq Ndini

Enriketa Ndini

Ervin Themeli

K. Ndini

E. Ndini

E. Themeli

35820

J. P. Benajati
03 MAJ 05.05.2006
(Signature)

KERKESE

KERKUESI: Kristaq Ndini I biri I Kalamit i dtl. 03.08.1960 lindur ne Berat banues ne Tirane, Rruga Sulejman Delvina P. 1/1, ap 16 madhor me zotesi te plote e juridike per te vepruar.

OBJEKT I: Kerkoj regjistrimin si person juridik te shoqerise "Auditing Partners" sh.p.k.

**GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR
TIRANE**

Ne ortaket e shoqerise "Auditing Partners" sh.p.k ne perputhje me legjislacionin ne fuqi kemi krijuar ne daten 01 . 05 .2006 nje shoqeri te perbashket me pergjegjesi te kufizuar.

1. Emertimi I shoqerise eshte "Auditing Partners" sh.p.k.
2. Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000 leke.
3. Selia e shoqerise eshte Rr. "Perlat Rexhepi", Nr. 16, ap. 12, Tirane.
4. Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet.
5. Administrator I shoqerise eshte Kristaq Ndini.
6. Ortake te shoqerise jane Kristaq Kalam Ndini, Enriketa Agron Ndini, Ervin Koco Themeli.
7. Objekti I veprimtarise se shoqerise do te jete : Auditim I llogarive, Konsulence financiare, kontroll I llogarive per likujdim shoqerish, bashkim shoqerish e veprime te ndryshimeve te kapitalit themeltar etj.. Per cdo sherbim ekonomiko- financiar qe rregullojne kete profesion..

Sa me siper I kerkojme kesaj gjykate qe ne baze te Ligjit 7667 date 28.01.1993 dhe te Ligjit 7638 date 19.11.1992 te regjistroje shoqerine "Auditing Partners" sh.p.k si person juridik.

Tirane me 01.05.2006

KERKUESI
Kristaq Ndini
K. Ndini

Emertimi i shoqerise
me num 25/05/2006
(Signature)
Enriketa Agron Ndini
(Signature)
Ervin Koco Themeli
(Signature)
deputet i krahut
01 31/5/2006

(Signature)
me num 87 dt 10/11/2006
Alberthina emri
(Signature)
noteru G. Broku

